



Të nderuar-a lexueso dhe lexues,
Mirë së vini në Buletinin e dytë, i cili shtypet në kuadër të projektit.
“Avokimi dhe ngritja e kapaciteteve për gratë vendimmarrëse në Rajonin e Pejës”.

Projekti ka për qëllim të ndërtoj kapacitete dhe të avokoj për implementimin e mekanizmave institucional për pjesëmarrjen e grave në proceset vendimmarrëse, përmes trajnimeve në barazinë gjinore, lobim dhe ngritje të spikatjes së grave në politikë.

“E dimë shumë mirë se punët që bejmë nuk janë më shumë se një pikë uji në oqean. Por, në qoftë se ajo pikë uji nuk është atje, oqeanit i mungon diçka”.

Nëna Terezë



Takimi i Grave Asambleiste të Regjionit të Pejës në Agjencionin për Barazi Gjinore(ZKM)

Kryeshefja e Agjencionit për Barazi Gjinore znj.Edona Hajrullahu pasi ju ka uruar mirëseardhje Grave Asambleiste të Regjionit të Pejës, në takimin e përbashkët, njoftues, me Agjencinë për Barazi Gjinore tha se Republika e Kosovës për arritjen e barazisë gjinore në shoqërinë tonë ka në fuqi disa mekanizma ligjor dhe institucional të cilat janë:

- Ligji për Barazi Gjinore
- Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje
- Agjencia për Barazi Gjinore / ZKM
- Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Zhdukur dhe Peticione
- Zyrtarët për barazi gjinore në ministri dhe komuna.

Ndërkaq, duke parë nevojën e krijimit të kushteve ligjore për barazi gjinore, znj. Hajrullahu njoftoi asambleistët së Kuvendi i Republikës së Kosovës, në vitin 2004 ka miratuar Ligjin për Barazi Gjinore. “Më anë të këtij ligji mbrohet, trajtohet dhe vendoset barazia ndërmjet dy gjinive si vlerë themelore e zhvillimit demokratik dhe përcaktohen kushte dhe mundësi për barazi përmes politikave që mbështesin zhvillimin e gjithëanshëm, në mënyrë që gruaje në shoqërinë tonë të jetë një figurë e vlerësuar dhe të gëzojë autoritet si në familje ashtu edhe në shoqëri”, është shprehur Kryeshefja e Agjencionit.

Më pas, ajo ka bërë të ditur se ky ligj garanton dhe përcakton masat për të drejtat e barabarta, pasi barazia gjinore bazohet në parimin e sjelljes së njëjtë dhe në parimin e të ofruarit mundësi të barabarta.



Barazi gjinore do të thotë pjesëmarrje e barabartë e femrave dhe meshkujve në të gjithat fushat e jetës, pozitë të barabartë, mundësi të barabarta për të gëzuar të gjithat të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në zhvillimin e shoqërisë si dhe të kenë përfitim të barabartë nga të arriturat e këtij zhvillimi (Ligji për barazi gjinore)



Buletini apo letra informuese shtypet në kuadër të këtij projekti që po e implementon OJQ “Zana” në Klinë. “Ky projekt u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit.



Poashtu, gjatë fjalimit të saj, znj. Hajrullahu, ka njoftuar Asambleistët e Regjionit të Pejës edhe me një mekanizëm tjetër ligjor, i cili është poashtu i rëndësishëm, Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, i miratuar në vitin 2010 dhe që ka për qëllim parandalimin e dhunës në familje me masa të përshtatshme ligjore, duke u kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve, dhe personave me aftësi të kufizuara. Poashtu, me anë të këtij ligji parashihet edhe trajtimi i kryesve të dhunës në familje dhe lehtësimi i pasojave.

“Sa i përket mekanizmave institucional, me 1 shkurt 2005, Qeveria e Kosovës me Vendim ka themeluar Zyrën për Barazi Gjinore si organ të veçantë të Qeverisë së Kosovës konform Ligjit për Barazi Gjinore të miratuar nga Kuvendi i Kosovës –zyre e cila me pas, me 1 shtator të vitit 2006 shëndërrohet në Agjenci për Barazi Gjinore, në Zyrën e Kryeministrit”, ka thënë Kryeshefja e Agjencionit.

Gjatë këtij takimi, Asambleistët e Regjionit të Pejës janë njoftuar edhe për rëndësinë e Agjencionit për Barazi Gjinore i cili është është i mandatuar të monitorojë zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore duke promovuar vlerat dhe mundësitë e barabarta pa marrë parasysh përkatësinë gjinore. “Platforma me të cilën kjo Agjenci funksionon është PROGRAMI I KOSOVËS PËR BARAZI GJINORE - miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në vitin 2008”, ka bërë të ditur, znj. Edona Hajrullahu.

Ajo tha se kur flitet për dokumentet strategjike dhe politikat, Agjencia për Barazi Gjinore ka hartuar dhe bazohet në:

- Programin e Kosovës për Barazi Gjinore
- Programin e Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit 2011-2013
- Planin e Veprimit për Fuqizimin Ekonomik të Gruas 2011-2013, i cili është një plan që buron nga Programi i Kosovës për Barazi Gjinore
- Konventën CEDAW

“Fillimisht, Programi i Kosovës për Barazi Gjinore është një dokument i cili paraqet programin strategjik për integrimin e Barazisë Gjinore në politikat dhe programet publike të Qeverisë së Republikës së Kosovës”, ka thënë znj. Hajrullahu. Sipas saj ky program synon të krijojë një mjedis të përshtatshëm dhe specifik për ndryshime në kushtet e jetesës së grave dhe vajzave në Kosovë, si dhe për eliminimin e ndasive të cilat janë të lidhura ngushtë me varfërinë.

Ajo njoftoi se hartimi i Programit të Kosovës për Barazi Gjinore është bërë me fokus në 6 fusha specifike:

- (i) integrimi i grave në ekonomi;
- (ii) integrimi i grave në tregun e punës dhe përkujdesja sociale për kategoritë e prekura nga problemet sociale,
- (iii) gratë në proceset e vendimmarrjes,
- (iv) përkujdesja shëndetësore dhe qasja e femrave dhe meshkujve në shërbimet shëndetësore,
- (v) arsimiti,
- (vi) përfaqësimi dhe kontributi i tyre në kulturë dhe media,



“Në të njëjtën kohë, Qeveria e Republikës së Kosovës ka treguar vullnetin e përgjigjet dhe trajtimit të fenomenit të dhunës në familje me masa konkrete dhe efektive në kuadër të angazhimeve për sigurimin e mirëqenies së qytetarëve. Me këtë qëllim, Agjencia për Barazi Gjinore ka hartuar Programin e Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Planin e veprimit 2011-2014, i cili është miratuar me vendim të Qeverisë në gusht të vitit 2011, ku për zbatimin e tij, Qeveria e Kosovës ka ndarë për tre vjet shumën prej rreth 1.6 milion euro”, tha Kryeshefja e Agjencionit. Në vijim, gratë Asambleiste u njoftuan edhe me Programin kundër Dhunës në Familje, që sipas znj. Hajrullahu, shërben si udhëzues në nivel shtetëror për përmirësimin e shërbimeve ekzistuese, dhe do të ndihmojë në zhvillimin dhe në mirëqenien e shoqërisë sonë në shtyllat: **parandalim dhe vetëdijësim; siguri dhe drejtësi, përkrahje dhe trajtim.**

Përveç prezentimit të agjencisë si dhe ligjeve dhe dokumenteve strategjike që janë në fuqi, znj. Hajrullahu, ka njoftuar edhe rreth synimeve të cilat i ka agjencia për vitin 2012.

Në planin e punës për këtë vit kemi paraparë një varg aktiviteteve tha ajo duke i përmendur edhe disa prej tyre si:

- Realizimin e një Hulumtimi socioligjor me temën **“E drejta pronësore e Gruas ndaj tokës në Kosovë”**,
- Organizimin e një Konference rajonale rreth çështjes së **“Fuqizimit dhe pavarësisimit ekonomik të gruas”**,
- Do mbështesim organizimin e Panairit tradicional **“Gratë në Biznes”**, i cili do realizohet në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë,
- Do ndahen rreth 10 bursa për avancimin akademik të Grave në shërbimin civil të Kosovës.

“Këto janë aktivitete për përmirësimin e objektivit të zbatimit të planit të veprimit për fuqizimin ekonomik të gruas”, tha znj. Hajrullahu e cila në vijim ka njoftuar edhe për objektivat që ka paraparë ABGJ-ja për të luftuar dhunën në familje, siq janë:

- Hartëzimi i shërbimeve sociale për rastet e dhunës në familje. Ky do jetë një sistem i informatizuar gjeografik që ofron të dhënat për shërbimet e ofruara në nivel të Kosovës, për rastet e dhunës në familje, dhe ndihmën që ofrojnë institucionet,
- Së shpejti pritet të fillojmë me punën për Hartimin e komentarit për Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje,
- Gjithashtu synojmë të themelojmë Sekretariatit për Çështje Gjinore dhe Siguri,

• Do të hartohet Plani i Veprimit për Zbatimin e Rezolutës -1325 Rezoluta “GRUAJA, PAQJA DHE SIGURIA”, e Këshillit të Sigurisë së OKB-së, e cila nxit shtetet anëtare, që të sigurojnë një përfaqësim më të madh të grave në të gjitha nivelet vendimmarrëse në institucionet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare dhe në mekanizmat për parandalimin, drejtimin dhe zgjidhjen e konfliktit.

Kryeshefja Hajrullahu, njoftoi se grupi punës për hartimin e këtij plani është themeluar javën e kaluar si dhe përfundimisht janë përgaditur termat e referencës për realizimin e një studimi i cili ka të bëjë me Monitorimin e mediave dhe që do jetë me fokus në paraqitjen e gruas në politikë.

Pasi ka përfunduar fjalën e saj, znj. Edona Hajrullahu, Kryeshefja e Agjencionit për Barazi Gjinore, u është përgjigjur pyetjeve që kanë parashtruar Gratë Asambleiste të Regjionit të Pejës.

Kanë vazhduar trajnimet e radhës me gratë Asambleiste të Regjionit të Pejës në kuadër të projektit "Avokimi dhe ngritja e kapaciteteve për gratë vendimmarrëse në Rajonin e Pejës", projekt ky që po implementohet nga OJQ "ZANA" Klinë

Trajnimi "Konventa CEDAW dhe obligimet e shteteve nënshkruese", i mbajtur me 05.12.2011.

Në këtë sesion trajnuet pjesëmarrëset janë njohur me Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas "CEDAW" dhe implementimin e kësaj Konvente në praktikë, gërshetimin e saj me instrumentet tjera ligjore, fuqinë e saj suplementare ndaj legjislacionit vendor dhe mënyrën e raportimit për implementimin e saj.

Trajnimi "Integrimi gjinor dhe Buxheti nën perspektivën Gjinore", mbajtur me 06.12.2011.

Në këtë sesion trajnuet pjesëmarrëset janë njohur me mënyrën e përfshirjes së qështjeve gjinore në politikën komunale dhe integrimi i këtyre politikave me përfshirje gjinore si dhe mënyrën e hartimit të buxhetit gjinor duke i përfshirë institucionet dhe mekanizmat kompetent për hartimin e këtij buxheti.

Trajnimi "Menaxhimi i Projekteve dhe Hartimi i Projekteve nën perspektivën Gjinore", mbajtur me 07.12.2011.

Ky trajnim më shumë është konceptuar në aspekt të ngritjes së kapaciteteve të pjesëmarrëseve që të aftësohen në hartimin e Projekt Propozimeve, në mënyrë të ngritjes së fondeve për të bërë ndryshime pozitive në komunitetin ku jetojnë. Më pas, në grupe punuese, pas instruksioneve të marra, janë zhvilluar draft projektet e tyre sipas nevojave të lokaliteteve ku ato jetojnë.

Grupet punuese kanë prezentuar projektet e tyre ku edhe kanë diskutuar me gratë pjesëmarrëse dhe të tjerët prezent gjatë këtij trajnimi.

Konkluzionet nga trajnimet :

Nga të gjitha Sesionet trajnuese është vërejtur interesim i madh rreth temave të trajnimeve, poashtu pjesëmarrëset kanë kontribuar me ide dhe janë angazhuar gjatë punës nëpër grupet punuese sipas temave të sesioneve trajnuese.

Pjesëmarrëset janë zotuar për angazhim të mëtejshëm të tyre në zhvillimin dhe implementimin e barazisë gjinore në kuvendet komunale të tyre duke kontribuar me eksperiencën e marrë gjatë këtyre sesioneve trajnuese.

OJQ "ZANA" gjatë të gjitha sesioneve trajnuese ka dhënë mbështetje dhe këshilla duke përfshirë edhe zotimin e saj për partecit në projektet e ardhshme të cilat do të prezantohen nga grupi i grave tek përfaqësuesit komunal dhe donatorët e mundshëm, duke mbështetur iniciativat e tyre brenda lokaliteteve ku jetojnë dhe veprojnë ato.



TEUTA KRASNIQI

Klinë
Subjekti politik: PDK
Shkollimi :
Fakulteti i Edukimit, Prishtinë

Teuta Krasniqi, Këshilltare në KK Klinë nga radhët e Partia Demokratike e Kosovës Klinë, thotë se pozita e femrës në shoqërinë kosovare në tërësi, e pa përjashtuar edhe në Komunën tonë ende nuk ka arritur atë stad të cilin synojmë ne, si një shoqëri demokratike.

Të rikujtojmë se në vitin 2008, bazuar në Ligjin për Barazi Gjinore të vitit 2004, Kosova ka hartuar planin e vet për Barazi Gjinore, plan i cili shumë qartë thekson se grujat duhet të jetë e integruar në të gjitha fushat me interesa të përgjithshme, do të thotë pjesëmarrje e barabartë e grave dhe burrave në jetën sociale, ekonomike, politike me mundësi të barabarta për të gëzuar të gjitha të drejtat e tyre dhe në mënyrë që ti kontribuojnë shoqërisë njejtë sikur dhe burrat.

Edhe pse ky synim është imperativ për Kosovën, pikësepari për përmirsimin e mirëqenjes sociale të shoqërisë sonë e më pastaj edhe një ndër parakushtet drejt integritimeve rajonale e më gjerë, ne ende kemi shumë punë për të bërë në këtë drejtim.

Po ashtu, Zonja Krasniqi citoi Kofi Annan-in: "Barazia gjinore është më shumë se një synim në vehte. Është parakusht për të kaluar sfidat e uljes së varfërisë, ngritjen e zhvillimit ekonomik dhe ndërtimit të një qeverisje të mirë"

Në teori, Asambleja Komonale ku unë jam anëtare, ka bërë përpjekje që të rris pjesëmarrjen e gruas në shumë aspekte, por në praktikë, një synim i tillë ende nuk është afër, ose më mirë me thënë është larg.

Shembuj të kësaj, janë struktura e bordit të drejtorëve si dhe disa komitete komunale thelbësore, ku fare nuk ka pjesëmarrje të gruas. Shembuj tjerë ka në institucionet arsimore të Komunës, ku grujat ka pjesëmarrje jashtëzakonisht të vogël në postet menagjuese, pos dy drejtoreshave në dy shkolla fillore dhe atë të qerdhës në Klinë, përkundër numrit të madh të femrave mësimitdhënëse.

Po ashtu, me tej z. Krasniqi potencoi si brengë tjetër, sektorin privat, nga të dhënat që ne kemi në dispozicion, femra ka nivel shumë të ultë të pjesëmarrjes në biznes, të mos them fare nuk ka. Ne shpesh i qasemi vetëm pjesëmarrjes së femrave në nivelet e menagjimit publik, por nëse vërtetë synojmë një zhvillim të sigurt të shoqërisë sonë, qasje të barabartë duhet të ketë edhe sektori privat.

Ende, përkundër përmirësimit të vazhdueshëm të arsimimit të femrave në Kosovë rrjedhimisht edhe në Klinë, pak biznese të mëdha menagjohen nga gratë. Ato (gratë) ende merren me biznese të vogla, si psh. rrobaqepësi, përpunim dhe shitje të prodhimeve bujqësore, shërbime të ndryshme. Realisht, detyrimi dhe përgjegjësia ndaj familjes dhe punëve të shtëpisë, ende janë barrierat ndër kryesoret që parandalojnë përfaqësim më cilësor të gruas në biznese të mëdha.

Duke parë këto që u thanë më lart, grupi i femrave anëtare të Asamblesë Komonale në Klinë së bashku me OJQ "ZANA" ka formuar Grupin e Grave Asambleiste, në mënyrë që të luaj një rol më të fuqishëm në promovimin e përfshirjes sa më të madhe të gruas në jetën shoqërore, politike dhe ekonomike. Këto ditë nën organizimin e drejtoreshës së OJQ -së "Zana" Klinë znj. Tahire Gashi realizuam edhe një takim me Agjencionin për Barazi Gjinore në Kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe Presidenten e vendit Z. Jahjaga lidhur me rolin e femrës në vendimarrje, kjo në kuadër të projektit "Fushatë avokuese për ndërtimin e kapaciteteve për gratë vendimmarrëse në regjionin e Pejës". Qëllimi i këtyre dy takimeve, ishte krijimi i një kanali të ri të komunikimit në mes të Institucioneve të Nivelit Qendror dhe përfaqësuesve politike lokale të Asambleve Komonale të Regjionit të Pejës.

Synimet strategjike të grupit të grave asambleiste janë:

- Përhapja e vlerave dhe praktiva më të mira që promovojnë barazinë gjinore
- Arsimim më cilësor dhe më sasior i femrave, posaqërisht në nivelin universitar
- Fuqizimin ekonomik të femrës përmesë nxitjes së femrave që të jenë udhëheqëse të bizneseve
- Rritja e përqindjes së pjesëmarrjes së femrës në nivelet menagjuese komunale (Komitete, Bordin e Drejtorëve, menagjim të shkollave etj.)

Ne si grup, me përkrahje të strukturave komunale dhe OJQ-ve që avokojnë për barazinë gjinore, synojmë që të:

- shpërndajmë ose të promovojmë këto synime direkt tek femra Klinase, përmes vizitave nëpër qendrat më të mëdha në komunën tonë.
- Tutje, përmes marrjes së disa shembujve konkretë ku gratë janë menagjuese dhe lidere të mira të biznesve private nëpër Kosovë, të mundohemi që edhe në Klinë të kemi ndonjë rast të tillë të sukseshëm.
- Të organizojmë takime me gratë, debate, etj.

Në fund, grupi i femrave asambleiste, do të vazhdojë që të jetë një zë i fuqishëm i femrës klinase, me moton: "Vetëm të bashkuara mund të jemi të barabarta në shoqëri" potencoi z.Krasniqi.



QEFERE IBRAHIMAJ

Subjekti politik: LDK
Shkollimi: Profesoreshë
Letërsi dhe Gjuhë Shqipe

Qefere Ibrahimaj, Përgjegjëse e Sektorit për Kulturë pranë Drejtorisë për Arsim dhe Kulturë në Istog, nga radhët e LDK-së, dhe se gjatë punës së saj është përkushtuar në këtë Drejtori ku punon në ngritjen e vetëdijës dhe mirëqenjes dhe kulturës së femrës-gruas kosovare në komunën e Istogut.

Roli i gruas në vendimarrje në Komunën e Istogut është jashtëzakonisht i vogël, ngase as një femër nuk është drejtor i ndonjë nga drejtoritë komunale, përveç dy femrave njëra është Menaxhere e Zyrës së Prokurimit e tjetra Menaxhere e Tatimit në Pronë.

Gruaja nuk ka mundësi të arrijë, ta marrë kuotën e mjaftueshme të votave në zgjedhje ngase femra-femrën nuk e voton jo vetëm për shkak të përcaktimeve partiake por edhe për shkak të pikëpamjeve tjera, siç është xhelozia, fenomen i karakterit të tyre.

Edhe pse në masë jo të mjaftueshme, pjesërisht gruaja Istogase është e kyçur në aktivitete kulturore, arsimore, politike, artizanate-punë-dore etj.

Me 30% në politikë, e mendoj diku rreth 40% nëpër institucione të ndryshme, ku bashkëpunimi është përgjithësisht i mirë, shprehet z.Ibrahimaj.

Femrat duhet të përfaqësohen në mënyrë të barabartë me gjininë e kundërt në vendet udhëheqëse ngase femra është njësoj dhe shumë herë më e arsyeshme se sa mashkujt në marrjen e vendimeve të prera dhe të sigurta.Mirëpo edhe vullneti i udhëheqësve mungon për pjesëmarrjen e grave në pozita vendimmarrëse.

Papunësia në zonat rurale është shumë e madhe, duhet ndërmarr hapa që të zhvillohet ekonomia në mënyrë që të vije deri te punësimi i tyre.

Nuk është duke u zbatuar në masë të pritshme ligji për barazi gjinore, edhe pse ky ligj parashef të drejta të barabarta për të dy gjinitë dhe për zbatueshmërinë e këtij ligji kërkohen plotësimë në mënyrë që ky ligj do të ishte më funksional dhe shumë pak është arritë përfaqësimi i gruas në procesin e punësimit dhe të vendimarrjes.

Zgjerimi dhe përkrahja e veprimtarive që lidhen me zejet e rrobaqepësisë, floktarisë, kuzhinës dhe artizanate tjera të cilat do të ndikonin në punësimin e grave.

Roli i femrës do t'ishte edhe më i fuqishëm nëse ajo nuk heziton, pikësepari të ngitë zërin për të drejtat e veta ngase femra është ajo që nëpër dekada e shekuj e begatoi familjen dhe e bëri trashëgiminë e saj.

SUZANA MURIQI

Subjekti politik: LDK
Kuvendi Komunal: Pejë
Master i shkencave matematiko-natyrore (master i kimisë)



Si këshilltare e kuvendit komunal të Pejës kam për obligim përfaqësimin e qytetarëve të kësaj komune në mënyre sa më dinjitoze dhe për ngritjen e vlerave të shoqërisë pa dallime gjinie, feje, race.

Një ndër qështjet që mendoj se duhet angazhuar dhe paraqet një ndër sfidat kryesore të shoqërisë sonë është pjesëmarrja e gruas në vendimarrje, pjesëmarrje e cila është e përcaktuar me ligj dhe e siguruar përmes kutoës. Andaj si synim duhet të kemi pikë së pari zbatimin e ligjeve në fuqi të cilat janë aprovuar në kuvendin e republikës së Kosovës, duke përfshirë këtu ligjin për barazi gjinore i cili i siguron gruas të drejta të barabarta dhe përfaqësimin të barabartë të gruas nëpër institucione.

Në bazë të informative që kemi nga komuna jonë shihet qartë se ky ligj nuk implementohet aq sa duhet dhe aq sa të obligon duke marrë në konsideratë numrin e femrave të cilat janë të kyqura nëpër institucione dhe në ekzekutivin komunal, ku nga 14 drejtorate vetëm 3 prej tyre janë femra, nga 36 shkolla të komunës sonë kemi vetëm 7 drejtoresha dhe vetë një zëvendës drejtoreshë, nuk kemi përfaqësim gjinor as në komitetin obligativ, pra në komitetin për politikë dhe financa. Për këtë arsye duhet të jemi të bashkuara dhe të ngrisim zërin fillimisht për implementimin e ligjit për barazi gjinore dhe të ndikojmë te femrat për avancim profesional e cila do ju ndihmonte shumë në pavarësimin e tyre ekonomik, factor kyq që ndikojnë në përmirësimin e jetës së gruas.

Duke u bazuar në disa suksese të grave të deritanishme në jetën politike besoj që grujat do të gjej përkrahje dhe me të madhe në të ardhmen e sidomos femrat e reja për të cilat besoj që kyqja e tyre në jetën politike është më së e nevojshme për vendin tonë duke e pasur parasysh përqindjen më të madhe të popullsisë sonë që e përbëjnë të rinjtë dhe femrat.

Nuk kërkoj që ne të përkrahemi vetëm si femra apo vetëm sa për të plotësuar numrin, por duhet të përkrahemi si vlera dhe të respektohen të drejta tona që na janë garantuar përmes ligjeve.

Ajo qka është e rëndësishme për tu potencuar është bashkëpunimi në nivel me shoqërinë civile dhe me mediat, bashkëpunim i cili do ndihmojë më shumë që të dëgjohet zëri i femrës dhe do ndihmojë më shumë në promovimin e vlerave të tyre, që për momentin është prioritet ndër priorite gjatë këtij mandati si asambleiste.